

---

---

## Termat e Referencës për Hetimin Pajtueshmërisë të IFC

*Enso Shqipëri (Projekti i IFC #30979)*  
*Shqipëri*

*Ankesa 01*

---

---

### **Informacion mbi CAO**

Misioni i CAO është që të shërbejë si një mekanizëm i pavarur, i drejtë, i besuar, dhe efektiv për ankim dhe për të përmirësuar përgjegjshmërinë mjedisore dhe sociale të IFC dhe MIGA.

CAO (Zyra e Avokatit të Popullit Këshilltar për Pajtueshmërinë) është një post i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Presidentit të Grupit të Bankës Botërore. CAO shqyrton ankesat nga komunitetet e prekura nga projektet e zhvillimit të ndërmarra nga të dy krahët e sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore, Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Agjencia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA),

Nëse CAO arrin në përfundimin se palët nuk janë të gatshme apo të afta për të arritur një zgjidhje të ndërmjetësuar, dosja transferohet tek zyra e pajtueshmërisë në CAO për të vlerësuar nëse shqetësimet e ngritura në ankesë meritojnë një hetim të pajtueshmërisë të IFC / MIGA.

Fokusi i zyrës së pajtueshmërisë në CAO është tek IFC dhe MIGA, dhe jo tek klienti i tyre. Kjo vlen për të gjitha aktivitetet e biznesit të IFC-së, duke përfshirë sektorin e pasurive të paluajtshme, tregjet financiare dhe veprimtarinë këshilluese. CAO vlerëson se si IFC/MIGA sigurohet për kryerjen në mënyrë të përshtatshme të veprimtarisë së saj të biznesit apo veprimtarisë këshilluese, si dhe nëse rezultatet e aktivitetit të biznesit apo veprimtarisë këshilluese janë në përputhje me qëllimin e dispozitave përkatëse të politikave. Megjithatë, në shumë raste të vlerësimit të ekzekutimit së projektit dhe zbatimin nga ana e MIGA/IFC të masave për zbatimin e standarteve përkatëse, del e nevojshme që CAO të shqyrtojë veprimet e klientit dhe të verifikojë rezultatet në terren.

CAO i raporton rezultatet e hetimit të saj të përputhshmërisë në një raport të hetimit nëpërmjet të cilit informon Presidentin dhe Bordin e Grupit të Bankës Botërore, drejtuesit e lartë të IFC/MIGA, dhe publikun në lidhje me vendimin e saj.

Për më shumë informacion në lidhje me CAO, ju lutemi vizitoni [www.cao-ombudsman.org](http://www.cao-ombudsman.org).

### **Sfond mbi investimin**

Më 28 shtator 2011, IFC miratoi një investim kapitali në fazë të hershme për Enso Hidro Energji sh.p.k., një kompani shqiptare "holding" themeluar nga Enso Hidro GmbH (referuar bashkërisht si "Enso" ose "klient"). Enso Hydro GmbH është një kompani austriake e specializuar në investime për projekte hidrocentrale në shkallë të vogël dhe të mesme.

Investimi i IFC-së ishte për kapital deri në shumën 6 milionë euro, që perfaqëson deri në njëzet për qind të kapitalit të papaguar të aksioneve të klientit. Qëllimi i investimit ishte mbështetja e ndërtimit të projekteve të hidrocentraleve në Lëngaricë dhe Mat, si dhe projekteve të tjera të

parashikuara për të ardhmen. Ky vlerësim i pajtueshmërisë ka të bëjë me një projekt hidrocentrali prej 8.9MW me bazë rrjedhën e lumit i përgatitur nga klienti, që do të ngrihet mbi lumin Lëngaricë në rrethin e Përmetit, prefektura e Gjirokastrës, në Shqipëri, ("projekti").

## **Ankesa**

Më 22 qershor 2015, Shoqata e Bujqësisë Organike paraqiti pranë CAO-s një ankesë në emër të popullatës së prekur nga projekti. Më 15 korrik 2015, CAO vendosi se ankesa ishte e drejtë. Pas një përpjekjeje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në shkurt 2016 ankesa është transferuar për shqyrtim në zyrën e pajtueshmërisë të CAO

Ankuesit pretendojnë se projekti shtrihet brenda kufijve të Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës. Ankesa pretendon shkelje të standardeve mjedisore dhe sociale (M&S) të IFC-së, ku përfshihen: mosrespektimi i legjislacionit kombëtar; mospërmbushja e detyrimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e habitateve natyrore dhe kritike; përfshirja e pamjaftueshme e komunitetit; dhe ndikimet negative në jetesën e bazuar tek turizmi.

## **Qëllimi (fushë-veprimi) i hetimit të pajtueshmërisë**

Në maj 2016, CAO publikoi një raport të vlerësimit të pajtueshmërisë në lidhje me shqyrtimin para-investimor dhe mbikëqyrjen e ndikimeve M&S të projektit hidroelektrik të Lëngaricës nga ana e IFC-së. CAO konstatoi se ankesa ngre çështje të rëndësishme në lidhje me vlerësimin dhe mbikëqyrjen e projektit nga ana e IFC-së, zgjidhja e të cilave kërkon marrjen në konsideratë në mënyrë të hollësishme nga ana e ekspertëve teknikë.

Fokusi i këtij hetimi të përputhshmërisë nga CAO është tek IFC, dhe se si IFC sigurohet për ekzekutimin e përshtatshëm mjedisor dhe social të investimit të saj në fazën e vlerësimit dhe gjatë mbikëqyrjes.

Metodologjia e hetimit të pajtueshmërisë përshkruhet në Udhëzimet Operative të CAO (mars 2013), dhe thekson se përkufizimi i hetimeve pajtueshmërisë i miratuar nga CAO është si më poshtë:

*Hetimi është një proces sistematik dhe i dokumentuar verifikimi nëpërmjet të cilit kryhet marrja dhe vlerësimi objektiv i provave për të përcaktuar nëse aktivitetet mjedisore dhe sociale, kushtet, sistemet e menaxhimit, apo informacioni i lidhur me to janë në përputhje me kriteret e hetimit të pajtueshmërisë.*

Siç përcaktohet në raportin e vlerësimit të CAO, CAO do të kryejë një hetim të pajtueshmërisë të investimeve të IFC-në tek klienti në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë. Hetimi i pajtueshmërisë do të shqyrtojë nëse investimi i IFC-së tek enso Shqipëri është vlerësuar, strukturuar dhe mbikëqyrur në përputhje me politikën, procedurat dhe standardet e aplikueshme të IFC-së. Gjithashtu, hetimi do të marrë në konsideratë nëse Politika dhe Standardet e Ekzekutimit të IFC-së, standardet e ekzekutimit për Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore si dhe Politika për Informimin të aplikuar për këtë projekt sigurojnë një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje.

Në kontekstin e politikave M&S, Standardeve dhe Procedurave të Ekzekutimit të IFC-së, hetimi i pajtueshmërisë nga CAO do të shqyrtojë:

1. Nëse shqyrtimi para-investimor i standardeve M&S të projektit nga ana e e IFC-së, dhe sidomos shqyrtimi i ndikimit të tij të mundshëm mbi biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit ishte proporcional me rrezikun;
2. Nëse IFC siguroi zbatimin e përshtatshëm të Standartit të Ekzekutimit No. 6 për këtë projekt, sidomos po të mbahet parasysh vendndodhja e projektit në një park kombëtar dhe prania e specieve të rralla dhe/apo të rrezikuara në këtë zonë; dhe
3. Nëse IFC siguroi zbatimin e përshtatshëm të standarteve të saj të konsultimit dhe të informimit për projektin.

Përveç kësaj, CAO do të shqyrtojë nëse shqyrtimi para-investimor nga ana e IFC-së ka konsideruar në mënyrë të përshtatshme ndikimet e projektit në aktivitetet e jetesën të bazuara tek eko-turizmi.

Si në të gjitha rastet, qëllimi (fushë-veprimi) i hetimit përfshin kuptimin e shkaqeve të menjëhershme dhe themelore për mospërmbushjen e identifikuar nga CAO.

### **Procesi i Hetimit të Pajtushmërisë dhe Afati Kohor Paraprak**

Afati kohor paraprak parashikon që CAO të hartojë një projekt-raport (raport paraprak) të hetimit të përputhshmërisë brenda muajit dhjetor 2016.

Një projekt-raport (raport paraprak) i hetimit do të shpërndahej tek drejtuesit e lartë të IFC-së dhe në të gjitha departamentet përkatëse të IFC-së për shqyrtim faktik dhe komente. Komentet e IFC-së duhet të paraqitet me shkrim tek CAO brenda 20 ditësh pune nga data e marrjes në dorëzim të projekt-raportit nga ana e IFC-së.

Mbas marrjes së komenteve nga IFC në lidhje me draftin e konsultimit (projekt-raportin), funksioni i pajtushmërisë tek CAO do të finalizojë raportin. Raporti final do t'i dorëzohet drejtuesve të lartë të IFC-së për përgjigje zyrtare. Njoftimi do të postohet në faqen e internetit të CAO. IFC duhet të paraqisë përgjigjen me shkrim tek CAO brenda 20 ditësh pune. CAO ia dërgon raportin e hetimit dhe përgjigjen e IFC-së Presidentit të Grupit të Bankës Botërore. Presidenti nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime në raportin e hetimit të pajtushmërisë, por mund të përfitojë nga kjo mundësi për të diskutuar konstatimet e hetimit me CAO.

Kur Presidenti e konsideron të kënaqshme përgjigjen e dhënë nga ana e drejtuesve të lartë të IFC-së, ai aprovon raportin e hetimit dhe përgjigjen. Aprovimi i raportit mbetet kompetencë e Presidentit. Mbas aprovimit, CAO e paraqet raportin e hetimit dhe përgjigjen e IFC-së tek Bordi. CAO lajmëron gjithashtu edhe palët e interesuara në lidhje me publikimin e të dy dokumenteve në faqen e internetit të CAO, dhe ia jep këto dokumenta edhe ankuesve.

### **Panelistët (Ekspertët) e jashtëm**

Në përputhje me praktikën e saj të konsoliduar, CAO do të angazhojë një apo disa ekspertë të jashtëm për të bashkëpunuar me ta në këtë detyrë. Për këtë hetim përputhshmërie, CAO konsideron kualifikimet e mëposhtme si të nevojshme për ekipin (ekspertët) e hetimit të pajtushmërisë:

- Ekspertizë të konsiderueshme në vlerësimin dhe menaxhimin e biodiversitetit në kontekstin e financave ndërkombëtare të lidhura me ekologjinë e lumit në sektorin hidroenergjetik.
- Njohuri të politikave, standardeve dhe procedurave M&S të IFC-së, sidomos të Standartit të Ekzekutimit 1 (Vlerësimi Social dhe Mjedisor dhe Sistemet e Menaxhimit) dhe Standartit të Ekzekutimit 6 (Ruajtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore).
- Përvojë dhe njohuri përkatëse mbi kryerjen e hetimeve të pajtueshmërisë.
- Aftësi të demonstruar në analizimin e politikave dhe praktikave dhe hartimin e propozimeve për reforma në kontekste institucionale komplekse.